



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.151/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Partija Kosovskih Srba (PKS), paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë, për shkak të dëmtimit të posterave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr. 151/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Partia e Serbëve të Kosovës PKS, me seli në Mitrovicë, kundër subjektit politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lista Serbe t'i shqiptohet dënim me gjobë për shkak të dëmtimit të posterave të subjektit ankues.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Partia e Serbëve të Kosovës (PKS), i cili pretendon se subjekti i tyre është i sulmuar nga aktivistët e subjektit politik, Lista Serbe. Në ankesë pretendojnë se aktivistët e Listës Serbe, Nenad Georgijev me të cilën thirret Tuta si dhe Sekuliq Bojan, të dytë nga komuna e Leposaviqit, të cilën sipas direktivave të subjektit politik, Lista Serbe në mënyrë aktive janë duke i shkatërruar posterat zgjedhor të PKS-së dhe duke vepruar në sy të dëshmitarëve të shumtë. Sipas pretenduesit në ankesë, kjo ngjarje ka ndodhur me datë 29.09.2019 në ora 11 e 30 në rrugën Magjistrale Mitrovicë-Jarinjë, në afërsi të fshatit Kamenicë. Lidhur me këtë rast pretenduesi i ankesës thekson se peronat në fjalë i kanë denoncuar në stacionin policor në Leposavic dhe policia ka dal në vend të ngjarjes dhe kanë përgatitur një raport policor duke e hapur hetimin ndaj këtyre personave në fjalë. Me propozim pwr panelin qw tw pranohet ankesa.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik Partija Kosovski Srba, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lista Serbe, me pretendimin se pjesëtarët e kësaj partie kanë shkatërruar posterët e ankuesit, madje si provë kanë bashkangjitur disa foto ku shihen posterët e dëmtuar.

Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit Lista Serbe për të dhënë përgjigje, e po ashtu meqenëse ka dyshime për vepër penale i është dërguar Policisë për të ndërmarr veprime hetimore.

Subjekti politik Lista Serbe nuk ka dhënë përgjigje, ndërsa nga ana e Policisë është konfirmuar veprimet e të njëjtëve duke dalur në vendin e ngjarjes, pastaj duke intervistuar shoferin e automjetit zyrtar i cili kishte qenë i parkuar por pa tabela të regjistrimit. Policia në raport ka njoftuar PZAP se i ka shqiptuar gjobë për shkak të mos vendosjes së tabelave, ndërsa janë duke punuar në drejtim të zbardhjes së rastit.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë konstatoi se nuk ka dyshim që posterat janë dëmtuar sepse kjo vërtetohet përmes fotove, mirëpo me asnjë provë nuk mund të vërtetohet se dëmtimin e posterave e kanë bërë aktivistët e subjektit politik Lista Serbe, pra me anë të ankesës k mund të vërtetohet se subjekti Lista Serbe është përgjegjës për shkelje të nenit 33 paragrafi 1 pika b e cila i referohet rasteve të largimit, dëmtimit të posterave të subjektit ankues.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 151/20179 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së